



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 27 nëntor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Pranimin e Dokumenteve të Treguara W04769-ës

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21 dhe 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137-139 dhe 153-155 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11-12 dhe 16-17 tetor 2023, W04769 dëshmoi në këtë proces.¹
2. Më 19 tetor 2023, Mbrojtja e Kadri Veselit ("Mbrojtja e Veselit") dorëzoi kërkesë për pranimin e tri materialeve që u përdorën gjatë dëshmisë së W04769-ës ("Kërkesa e Veselit").²
3. Më 27 tetor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrime ("Parashtrimet e ZPS-së")³ në të cilat: (i) kërkoi pranimin e katër materialeve të përdorura gjatë dëshmisë së W04769-ës ("Kërkesa e ZPS-së"),⁴ të cilat ishin shënuar më parë për identifikim;⁵ dhe (ii) u përgjigj ndaj Kërkesës së Veselit ("Përgjigjja e ZPS-së").⁶

¹ Transkriptet e seancës, 11-12 dhe 16-17 tetor 2023, f. 8679-9095.

² F01871, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Pranimin e Materialeve të Përdorura Gjatë Marrjes në Pyetje të W04769-ës*, 19 tetor 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-3, konfidenciale. *Shih gjithashtu Transkripti i seancës, 16 tetor 2023 ("Transkripti i datës 16 tetor 2023")*, konfidencial, f. 8935, rreshti 18 deri f. 8936, rreshti 8.

³ F01892, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Pranueshmërinë e Materialeve pas Dëshmisë së W04769-ës*, 27 tetor 2023, konfidencial.

⁴ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 1-2, 3-20, 27. *Shih gjithashtu Transkriptin e seancës, 17 tetor 2023 ("Transkripti i datës 17 tetor 2023")*, f. 9038, rreshtat 7-10, deri f. 9067, rreshtat 15-19.

⁵ Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 9035, rreshti 25 to f. 9038, rreshti 10.

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1-2, 21-25, 27.

4. Më 3 nëntor 2023, në bazë të kërkesës së Mbrojtjes së Veselit,⁷ Trupi Gjykses zgjati deri më 8 nëntor 2023 afatin për kundërpërgjigje të Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së ZPS-së.⁸
5. Më 8 nëntor 2023, Mbrojtja e të katër të akuzuarve ("Mbrojtja") dorëzoi parashtrime të përbashkëta ("Parashtrimet e Mbrojtjes"),⁹ në të cilat: (i) Mbrojtja u përgjigj së bashku ndaj Kërkesës së ZPS-së ("Përgjigjja e Mbrojtjes");¹⁰ dhe (ii) Mbrojtja e Veselit u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes së ZPS-së.¹¹
6. Më të njëjtën datë, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit") dorëzoi parashtrime shtesë si përgjigje ndaj Kërkesës së ZPS-së ("Përgjigjja e Thaçit").¹²
7. ZPS-ja nuk u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes apo ndaj Përgjigjes së Thaçit.
8. Më 22 nëntor 2023, sipas udhëzimit të Trupit Gjykses, Mbrojtja e Veselit dorëzoi përkthimin në anglishte të njëres prej provave materiale të paraqitura për pranim në Kërkesën e Veselit.¹³

⁷ CRSPD351, *Mesazh Elektronik i NJAGJ-së Dërguar Trupit Gjykses në lidhje me Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes së Veselit për Zgjatje Afati për Kundërpërgjigje ndaj F01982*, 3 nëntor 2023, konfidencial.

⁸ F01905, *Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Zgjatje Afati për Pranimin e Materialeve të Përdorura ndaj F01892*, 3 nëntor 2023, para. 6-7.

⁹ F01911, *Mbrojtësi i Specializuar, Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Pranueshmërinë e Materialeve pas Dëshmisë së W04769-ës*, 8 nëntor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-3, konfidenciale.

¹⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 1-2, 6-38, 46(i)-(ii).

¹¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 1, 39-44, 46(iii).

¹² F01915, *Mbrojtësi i Specializuar, Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtjes së Thaçit si Përgjigje ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Pranueshmërinë e Materialeve pas Dëshmisë së W04769-ës*, 8 nëntor 2023, konfidencial. Trupi Gjykses vë në dukje se, sipas informacionit në dispozicion në sistemin *Legal Workflow*, parashtrimi fillimisht u dorëzua më 8 nëntor, por u kthye për shkak të një gabimi administrativ, dhe pastaj u dorëzua përsëri më 9 nëntor 2023.

¹³ DKV0801-0802-ET (Lista e Provave e Kërkesës së Veselit F01871). *Shih gjithashtu CRSPD372, Përkthimi në anglishte i DKV0801-0802*, 22 nëntor 2023, konfidencial.

II. PARASHTRIMET

A. KËRKESA E VESELIT

9. Mbrojtja e Veselit parashtron se tri dokumentet që paraqet për pranim¹⁴ janë relevante,¹⁵ autentike¹⁶ dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet nga ndonjë efekt dëmtues i tyre.¹⁷ Në veçanti, ajo parashtron se këto dokumente përbëjnë pjesë të pandashme dhe të pazëvendësueshme të marrjes në pyetje të W04769-ës nga Mbrojtja dhe janë kyçe për vlerësimin e duhur të autenticitetit, mbështetshmërisë në to dhe vlerës provuese të provave materiale të pranuar më herët, P499 dhe P507.¹⁸

10. ZPS-ja përgjigjet se: (i) nuk kundërshton pranimin e DKV0801-0802, por Mbrojtja e Veselit duhet të përgatisë përkthimin në anglishte të këtij dokumenti para se ai të pranohet;¹⁹ dhe (ii) dy materialet e mbetura nuk duhet të pranohen, sidomos pasi ato përbëjnë deklaratë sipas rregullave 153-155.²⁰ Gjithashtu, ZPS-ja kundërshton ato që i përshkruan si 'pretendime të pabaza' të Mbrojtjes së Veselit se ZPS-ja 'paraqiti me vetëdije dokument të falsifikuar për pranim'.²¹

11. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se Kërkesa e saj duhet të miratohet, duke pretenduar se materialet e ofruara i përmbushin kriteret për pranim.²² Ajo gjithashtu kundërpërgjigjet se disa faktorë mbështesin pretendimin e Mbrojtjes se nënshkrimi përkatës dhe provat materiale P499 dhe P507 në tërësi janë të falsifikuara.²³

¹⁴ *Shih* Kërkesën e Veselit, para. 1, 15: f. 1-4 të 077601-TR-ET Pjesa 4 RED (Shtojca 1 e Kërkesës së Veselit); f. 28-30 e 077596-TR-ET Pjesa 4 RED (Shtojca 2 e Kërkesës së Veselit); DKV0801-0802 (Shtojca 3 e Kërkesës së Veselit).

¹⁵ Kërkesa e Veselit, para. 2, 7-13. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Veselit, para. 3-5.

¹⁶ Kërkesa e Veselit, para. 2, 6.

¹⁷ Kërkesa e Veselit, para. 2, 7-13.

¹⁸ Kërkesa e Veselit, para. 2, 3-5.

¹⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22.

²⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 23-24, 27.

²¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 25, *i referohen* Kërkesës së Veselit, para. 13.

²² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 44, 46(iii).

²³ *Shih, në veçanti*, Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40, 42-43.

B. KËRKESA E ZPS-SË

12. ZPS-ja parashtron se katër dokumentet që kërkon t'i paraqesë ("materialet e ZPS-së")²⁴ i plotësojnë kushtet për pranueshmëri.²⁵ Ajo gjithashtu parashtron se nuk është e ndaluar që një palë të paraqesë materiale për pranim që janë përdorur gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga gjykatësit dhe se ZPS-ja ka qenë e qartë në synimin për t'u mbështetur në këto materiale.²⁶

13. Në Përgjigjen e vet, Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykses të shtyjë vendimin në lidhje me pranimin e P650 MFI deri pas dëshmisë së W04765-ës ose të W03873-shit, duke argumentuar se: (i) në thelb W04769 nuk ishte në gjendje të jepte informacion për këtë material dhe ishte shumë skeptik për autenticitetin dhe mbështetshmërinë në këtë material; dhe (ii) W04765 dhe W03873 do të ishin dëshmitarë shumë më të përshtatshëm për të paraqitur këto materiale.²⁷ Mbrojtja gjithashtu kërkon që Trupi Gjykses të mos pranojë P651 MFI me arsyetimin se ekzistojnë dyshime të mëdha në lidhje me autenticitetin dhe mbështetshmërinë në këtë material.²⁸ Ajo parashtron në këtë aspekt se: (i) lloji dhe thelbi i P651 MFI është në vetvete i dyshimtë²⁹ dhe kronologjia e mbajtjes së tij në ruajtje është komprometuar rëndë;³⁰ dhe (ii) autenticiteti dhe mbështetshmëria në dokumentet në të cilat mbështetet ZPS-ja për konfirmimin e këtij materiali, janë njëlloj të dyshimta kështu që P651 MFI nuk përforcohet nga këto dokumente dhe e kundërta.³¹ Mbrojtja gjithashtu parashtron se

²⁴ P649-P652 MFI. *Shih* më poshtë, poshtëshënimet 41, 47, 50, 63.

²⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2-3.

²⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 4.

²⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2, 6-7, 44, 46(i).

²⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2, 8-38, 44, 46(ii). Trupi Gjykses vë në dukje se, megjithëse në paragrafin 2 të Parashtrimeve të Mbrojtjes gjithashtu përmendet P649 MFI, ky material nuk trajtohet më tej në Parashtrimet e Mbrojtjes dhe nuk është përfshirë në paragrafin përmbyllës (*shih* Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 46; *shih gjithashtu* Përgjigja e Thaçit, poshtëshënimi 3).

²⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10, 12-19.

³⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10, 20-30.

³¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10, 31-38.

pranimi i P650-P651 MFI pashmangshëm do të dëmtonte të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë.³²

14. Në Përgjigjen e Thaçit, Mbrojtja e Thaçit argumenton se W04769 nuk është dëshmitari i duhur përmes të cilit të paraqitet P649 MFI, duke pretenduar se ai nuk ishte në gjendje të konfirmonte nëse ky material pasqyrore saktë qëndrimin e W04564-ës. Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit kërkon që Trupi Gjykses të shtyjë vendimin mbi pranimin e P649 MFI deri në dëshminë e W04564-ës.³³

III. DISKUTIM

A. KËRKESA E VESELIT

1. Deklaratat e dëshmitarëve

15. Trupi Gjykses vëren se faqet 1-4 të 077601-TR-ET Pjesa 4 RED dhe faqet 28-30 të 077596-TR-ET Pjesa 4 RED (së bashku, “deklaratat e dëshmitarëve”) janë pjesë të transkripteve të intervistave të dëshmitarëve të ZPS-së. Edhe pse individët në fjalë nuk janë në listën e dëshmitarëve të ZPS-së,³⁴ Trupi Gjykses gjykon se deklaratat e dëshmitarëve përbëjnë deklarata të dhëna nga dëshmitari në kontekst të procedurave ligjore, ose në lidhje me to dhe, si të tilla, përbëjnë deklarata me shkrim sipas rregullave 153-155.³⁵ Rrjedhimisht, pranimi i tyre bëhet sipas ë kriterëve të rregullave 153-155, të cilat nuk janë përmbushur në këtë fazë.

³² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2.

³³ Përgjigja e Thaçit, para. 1-4.

³⁴ F01594/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimet nga Prokuroria të Listës së Përditësuar të Dëshmitarëve dhe Versionit më pak të Redaktuar të Dosjes Paraprake*, 9 qershor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua në të njëjtën ditë, F01594/A02).

³⁵ Sa i përket përkufizimit se çfarë përbën ‘deklaratë’ për të vendosur mbi pranimin e provave, *shih p.sh.* F01852, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Pranimin e Dokumentit Shtesë në Lidhje me W02153-shin*, 11 tetor 2023, para. 8, duke iu referuar F01380, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Dymbëdhjetë Dëshmitarëve të Parë të ZPS-së sipas Rregullës 154*, 16 mars 2023, konfidencial, para. 12, 26 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 7 nëntor 2023, F01380/RED). *Shih gjithashtu* F01700, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave nga W03724, W03832, W03880, W04368, W04566, dhe W04769 sipas Rregullës 154*, 24 korrik 2023, konfidencial, para. 68 (versioni i

16. Sa i përket parashtrimit të Mbrojtjes se Trupi Gjykses pranoi para pak kohësh pjesë të deklaratës së mëparshme të W04746-ës sipas rregullës 138(1) dhe se i njëjti arsyetim duhet të zbatohet këtu,³⁶ Trupi Gjykses kujton se, në vendimin përkatës, Trupi Gjykses ballafaqohet me situatën e deklaratave potencialisht mospërputhëse të dëshmitarit në fjalë, sipas rregullës 143(2)(c).³⁷ Rasti konkret është thelbësisht i ndryshëm sepse Mbrojtja e Veselit kërkon pranimin e deklaratave të individëve të ndryshëm nga W04769, sipas rregullës 138(1). Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se pranimi këtu kundërshtohet sepse nuk mund të bazohet në pajtimin e palëve për pranim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se krahasimi që bën Mbrojtja e Veselit është i gabuar.

17. Trupi Gjykses konstaton se deklaratat e dëshmitarëve nuk janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

2. Dokumenti i Universitetit të Prizrenit

18. DKV0801-0802³⁸ përbëhet nga një dokument i fakultetit juridik të Universitetit të Prizrenit ("dokumenti i Universitetit të Prizrenit"). Sa i përket relevancës, Trupi Gjykses gjykon se ky dokument është potencialisht relevant për vlerësimin e autenticitetit dhe vlerës provuese që i atribuohen provave materiale të pranuar të ZPS-së, P499 dhe P507.³⁹ Trupi Gjykses kujton se ZPS-ja nuk e kundërshton pranimin e këtij materiali.⁴⁰

19. Sa i përket autenticitetit, vlerës provuese dhe efektit dëmtues, Trupi Gjykses vë në dukje se dokumenti përmban nënshkrimin dhe datën, dhe mban vulat, numrin e

redaktuar publik u lëshua më 7 nëntor 2023, F01700/RED); KSC-BC-2020-07, F00334, Trupi Gjykses, *Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 29 shtator 2021, para. 84-87.

³⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 41, duke iu referuar F01903, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranim të Materialeve të Përdorura Gjatë Marrjes në Pyetje të W04746-ës* ("Vendimi i Datës 3 Nëntor 2023"), 3 nëntor 2023, para. 22-26.

³⁷ *Shih* Vendimin e Datës 3 Nëntor 2023, para. 22-26.

³⁸ Me përkthimin në anglishte DKV0801-0802-ET.

³⁹ *Shih gjithashtu* Transkriptin e seancës, 12 tetor 2023 ("Transkripti i datës 12 tetor 2023"), f. 8812-8814.

⁴⁰ *Shih* më lart, para. 10; Parashtrimet e ZPS-së, para. 22.

referencës, dhe të dhënat e kontaktit. Sidoqoftë, nënshkrimi nuk është konfirmuar deri më tani nga asnjë dëshmitar kështu që vlera provuese e tij është e kufizuar për vërtetimin e faktit se është dokument që supozohet se është nënshkruar nga personi në fjalë. Megjithatë, Trupi Gjyqësor është bindur se dokumenti i Universitetit të Prizrenit është autentik dhe me vlerë provuese *prima facie* dhe se vlera e tij provuese *prima facie* nuk zhbëhet nga efekti dëmtues i tij.

20. Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor pranon DKV0801-0802 sipas rregullës 138(1).

B. KËRKESA E ZPS-SË

1. P649 MFI⁴¹

21. Sa i përket relevancës, Trupi Gjyqësor gjykon se informacioni që përmban prova materiale P649 MFI, e cila përbëhet nga një intervistë me W04564-ën të botuar në një libër, është qartësisht relevant për aspekte të ndryshme në këtë çështje, përfshirë: (i) shkallën e sofistikut dhe organizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"); (ii) procesin e kristalizimit të strukturave të UÇK-së; (iii) funksionimin e hierarkisë komanduese dhe personelit përkatës; dhe (iv) rolin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor vë në dukje se nuk duket se Mbrojtja e Veselit kundërshton relevancën e materialit. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjyqësor është bindur se P649 MFI është relevant.

22. Sa i përket autenticitetit, Trupi Gjyqësor vëren se libri në të cilin është botuar P649 MFI përmban informacion për vendin, datën dhe personat e subjektet e përfshira në botim. Trupi Gjyqësor është bindur se P649 MFI është autentik *prima facie*.

23. Sa i përket vlerës provuese dhe efektit dëmtues, Trupi Gjyqësor vë në dukje se, edhe pse W04769 sugjeroi se kishte elemente të vetëlavdërimit në lidhje me

⁴¹ SITF00245547-SITF00245555-ET (dhe faqet përkatëse në origjinalin në gjuhën shqipe SITF00245505-00245703) dhe SITF00245555-SITF00245562-ET (dhe faqet përkatëse në origjinalin në gjuhën shqipe SITF00245505-00245703). Trupi Gjyqësor vë në dukje se ZPS-ja nuk i paraqet në këtë kohë faqet e tjera të P649 MFI përveç faqeve të shënuara, *shih* Parashtrimet e ZPS-së, titulli përpara para. 5, dhe poshtëshënimi 5.

rolin e të intervistuarit, W04769 e konfirmoi thelbin e dëshmisë së të intervistuarit në lidhje me ngjarjet dhe rrethanat për të cilat kishte njohuri.⁴² Gjithashtu, Mbrojtja ishte në gjendje ta merrte në pyetje W04769-ën në lidhje me ato pjesë. Për më tepër, Trupi Gjykses vë në dukje se: (i) Mbrojtja u mbështet dhe mori në pyetje W04769-ën në lidhje me një dokument tjetër autor i të cilit ishte i intervistuari (P506);⁴³ dhe (ii) i intervistuari është dëshmitar i ZPS-së (W04564) të cilin Mbrojtja do të jetë në gjendja ta marrë në pyetje nëse thirret të dëshmojë. Së fundi, sa i përket argumentit të Mbrojtjes së Thaçit se nuk ishte njoftuar se ky material do të diskutohet me W04769-ën,⁴⁴ Trupi Gjykses nuk është i detyruar të japë njoftim për dokumentet që mund të përdorë me dëshmitarin. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se dokumenti është nxjerrë për Mbrojtjen që një kohë të gjatë,⁴⁵ ishte në listën e provave materiale të mundshme të ZPS-së për t'u paraqitur dhe përdorur në gjykim⁴⁶ dhe kishte të bënte qartësisht me thelbin e dëshmisë së dëshmitarit dhe fushën e përgjegjësisë së tij. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se P649 MFI ka vlerë provuese *prima facie* që nuk zhbëhet nga efekti dëmtues i tij.

24. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses pranon si provë P649 MFI sipas rregullës 138(1).

⁴² Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 8997-9003, 9083-9084.

⁴³ Transkripti i datës 16 tetor 2023, *p.sh.* f. 8848-8852, 8868-8869, 8951-8952.

⁴⁴ Përgjigja e Thaçit, para. 2 dhe poshtëshënimi 5.

⁴⁵ *Shih p.sh.* Paketat 36, 64, 364 të Materialit të Nxjerrë.

⁴⁶ *Shih p.sh.* tashmë F00896/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit prej Prokurorisë të Listës së Ndryshuar të Provave Materiale dhe Parashtrime lidhur me Të*, 25 korrik 2022, konfidenciale (materialet 7783, 18064, 18067).

2. P650 MFI⁴⁷

25. Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja paraqiti vetëm faqet U003-1744 to U003-1746 të P650 MFI.⁴⁸ Këto faqe janë pranuar ndërkohë përmes W04765-ës në përputhje me rregullat 138(1) dhe 154.⁴⁹

26. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se është e tejkaluar pjesa e Kërkesës së ZPS-së që ka të bëjë me P650 MFI.

3. P651 MFI⁵⁰

27. Sa i përket relevancës së provës materiale P651 MFI, Trupi Gjykses gjykon midis të tjerash, se është relevant informacioni që përmban ky dokument, i cili përbëhet nga një fletore me shënime të shkruara me dorë që mbulon korrikun 1998 në zonën e gjerë të Prizrenit për: (i) ekzistencën, strukturën dhe funksionimin e hierarkisë komanduese të UÇK-së në zonën përkatëse, në veçanti sa i përket mbledhjes së informacionit në lidhje me të dyshuarit si bashkëpunëtorë; (ii) shkallën e sofistikimit të kësaj strukture dhe personelit të përfshirë; (iii) funksionimin, aktivitetet dhe përgjegjësitë e shërbimit të zbulimit; (iv) qëndrimin e UÇK-së ndaj të dyshuarve si 'bashkëpunëtorë' dhe burimeve të përdorura në këtë aspekt; (v) rolin dhe përfshirjen e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm në këtë zonë; (vi) rrethanat që çuan në arrestimin dhe ndalimin e W04571-shit; (vii) llojin e masave dhe hapave të marrë nga shërbimi i zbulimit; dhe (viii) identitetet e disa të dyshuarve si bashkëpunëtorë dhe arsyet e

⁴⁷ Faqet U003-1744-U003-1746 të U003-1741-U003-1749 dhe të U003-1744-U003-1748-ET. *Shih gjithashtu* para. 25 dhe poshtëshënimin 48 të këtij vendimi.

⁴⁸ Parashtrimet e ZPS-së, kreu përpara para. 9, dhe poshtëshënimin 10.

⁴⁹ *Shih* Transkriptin e seancës, 13 nëntor 2023, f. 9889, rreshti 25 deri f. 9890, rreshti 4 (*duke iu referuar, midis të tjerash, f. 116827-116829 të 116820-116829 [shih materialin 7 në f. 116828]*) dhe f. 9893, rreshtat 3-24. *Shih gjithashtu* F01901, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të W03170-ës, W04043-shit, W04444-ës, W04571-shit, W04765-ës, W04811-shit, dhe W04870-ës sipas Rregullës 154 dhe Kërkesën lidhur me To (F01830)*, 2 nëntor 2023, konfidencial, para. 68 dhe poshtëshënimin 150 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, F01901/RED).

⁵⁰ U000-6550-U000-6598; U000-6550-U000-6598-ET.

dyshimeve. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se nuk duket se Mbrojtja kundërshton relevancën e këtij materiali. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se P651 MFI është relevante.

28. Sa i përket autenticitetit, Trupi Gjykses thekson që në fillim se nuk ka bazë për të sugjeruar se dokumentet që burojnë ose janë dhënë nga autoritetet serbe janë të dyshimta *prima facie*.⁵¹ Trupi Gjykses kujton në këtë aspekt se Mbrojtja e Thaçit ka paraqitur disa dokumente që burojnë nga autoritetet serbe duke pretenduar vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.⁵²

29. Trupi Gjykses gjykon se autenticiteti *prima facie* i dokumentit është i qartë nga disa faktorë: (i) hollësitë faktike që jepen në fletore, përfshirë sa i përket incidenteve, rrethanave, vendeve dhe individëve në atë kohë; (ii) datat e këtyre incidenteve të ndryshme; (iii) emrat e disa individëve (roli dhe funksioni i të cilëve si anëtarë të ZKZ-së/zbulimit është konfirmuar);⁵³ dhe (iv) fakti që W04769 ishte në gjendje të komentonte për thelbin e elementeve të ndryshme që përmban ky dokument dhe të konfirmuar nga disa informacione që përmban ai.⁵⁴ Trupi Gjykses vë në dukje se provat materiale tashmë të pranuar P499/P507 dhe P74, për të cilat është konstatuar se janë autentike *prima facie*, vijnë nga e njëjta fletore.⁵⁵ Këto, sikurse P651 MFI, nuk përmbajnë asnjë tregues se janë falsifikime por, përkundrazi, janë autentike *prima facie*. Gjithashtu, Trupi Gjykses është i mendimit se nuk ka tregues se informacioni që përmbajnë këto dokumente ishte i njohur për persona jashtë UÇK-së. Pretendimi për të kundërtën që duket se i shtron Mbrojtja nuk bazohet në fakte. Për më tepër, nuk ka tregues se ndonjë informacion që përmbajnë ato është i rremë. Përkundrazi, siç vihet në dukje më

⁵¹ F01664, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të W00072-shit, W02153-shit dhe W04586-ës sipas Rregullës 154*, 10 korrik 2023, konfidencial, para. 35.

⁵² Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 8988-8990 (urdhri gojor në lidhje me provat materiale 1D59-1D61).

⁵³ *Shih, p.sh.*, f. U000-6567 dhe U000-6580.

⁵⁴ Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 9010-9018, 9068-9076.

⁵⁵ *Shih* Parashtrimet e ZPS-së, para. 16-18 dhe referencat e lidhura me të.

lart, W04769 ishte në gjendje të jepte të dhëna faktike shitesë në lidhje me këtë material dhe të konfirmojë saktësinë e një pjese të informacionit që përmban ai.⁵⁶

30. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes është bindur se materiali i propozuar është autentik *prima facie*. Në veçanti, Trupi Gjykes gjykon se dorëshkrimi dhe fjalori që mund të argumentohet se janë të ndryshëm në disa pjesë (të vogla) të materialit nuk e zhvlerësojnë si të tilla autenticitetin *prima facie* të materialit të tërë. Përfundimet e nxjerra nga Mbrojtja se si 'faqet inkriminuese' u gjendën në këtë dokument⁵⁷ janë krejtësisht spekulative, as nuk ka bazë për pretendimin⁵⁸ se informacioni është shtuar ose futur në këtë dokument nga palë të treta. Gjithashtu, Trupi Gjykes gjykon se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se si mospërputhja e numrave të regjistrimit të provës ("ERN") në origjinal dhe në përkthim do të cenonin autenticitetin e materialit. Përkundrazi, argumentet e lartpërmendura të Mbrojtjes ndikojnë në peshën, nëse do të ketë, që do t'i jepet materialit dhe/ose pjesëve të kundërshtuara. Ngjashëm, Trupi Gjykes gjykon se pretendimet e Mbrojtjes sa i përket cenimit të pretenduar të kronologjisë së mbajtjes në ruajtje nuk përbëjnë arsye për refuzimin e pranimit edhe pse ato mund të ndikojnë në peshën, nëse do të ketë, që Trupi Gjykes mund të jetë i gatshëm t'i japë këtij dokumenti.⁵⁹

31. Sa i përket vlerës provuese dhe efektit dëmtues, Trupi Gjykes kujton se W04769 ishte në gjendje të bënte komente për disa aspekte të këtij dokumenti.⁶⁰ Për të njëjtat arsye që janë shtjelluar në paragrafët 28-30 më lart në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykes nuk bindet se kundërshtimet e Mbrojtjes në këtë aspekt do të zhbënin vlerën

⁵⁶ Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 9010-9018, 9068-9076.

⁵⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 18.

⁵⁸ *Shih gjithashtu* parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit në Transkriptin e seancës, 30 tetor 2023, konfidencial, f. 9124-9126.

⁵⁹ *Shih gjithashtu p.sh.* F01596, Trupi Gjykes, *Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 9 qershor 2023, para. 109; KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjykes, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit*, 18 maj 2022, para. 28.

⁶⁰ Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 9010-9018.

provuese *prima facie* të këtij dokumenti.⁶¹ Trupi Gjykses është bindur për vlerën provuese *prima facie* të këtij dokumenti në lidhje me pikat e përshkruara në paragrafin 27 më lart sa i përket relevancës. Gjithashtu, Mbrojtja kishte mundësinë që t'i bënte pyetje W04769-ës në lidhje me këtë dokument,⁶² dhe ishte ose do të jetë në gjendje t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të tjerë të ZPS-së që japin dëshmi në lidhje me strukturën dhe funksionimin e UÇK-së në këtë zonë, përfshirë W04571-shin dhe W04765-ën. Mbrojtja gjithashtu ishte në gjendje të bënte parashtrime dhe pyetje në lidhje me pranueshmërinë e dokumenteve shoqëruese, në veçanti në lidhje me provat materiale P499/P507 dhe P74. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se P651 MFI ka vlerë provuese *prima facie* që nuk zhbëhet nga efekti i tij dëmtues.

32. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e pranon P651 MFI sipas rregullës 138(1).

4. P652 MFI⁶³

33. Trupi Gjykses vëren se ky material përmban vendimin e datës 2 nëntor 1998 në lidhje me strukturat e reja të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Nuk duket se Mbrojtja kundërshton pranimin e tij.

34. Sa i përket relevancës, Trupi Gjykses gjykon se ky dokument është relevant, midis të tjerash, në lidhje me: (i) rolin dhe kompetencat e disa anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në një kohë të caktuar; (ii) marrëdhënien midis UÇK-së në njërin anë dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës ("LDK") dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës ("FARK") në anën tjetër; (iii) strukturën e UÇK-së në momente të caktuara; dhe (iv) rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Adem Demaçit.

⁶¹ *Shih* Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10-38.

⁶² Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 9068-9076.

⁶³ 061168-061168-ET dhe faqja përkatëse origjinale në gjuhën shqipe 061167-061171. Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk paraqet në këtë kohë faqet e tjera të P652 MFI përveç kësaj faqeje të vetme, *shih* Parashtrimet e ZPS-së, titulli përpara para. 13, dhe poshtëshënimi 12. Nëse ZPS-ja do të kërkojë të paraqesë f. 061170 (*shih* Parashtrimet e ZPS-së, poshtëshënimi 12), së pari duhet të paraqesë këtë faqe ndaras dhe të japë përkthimin e nevojshëm të atij dokumenti.

Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se P652 MFI është relevant.

35. Sa i përket autenticitetit, Trupi Gjykses vëren se ekzistojnë shenja të ndryshme që tregojnë origjinën e dokumentit. Gjithashtu, ai përmban datën, nënshkrimet e personave në fjalë, dhe mban vulat e UÇK-së dhe të qeverisë së Kosovës në mërgim. Trupi Gjykses është bindur se P652 MFI është autentik *prima facie*.

36. Sa i përket vlerës provuese dhe efektit dëmtues, Trupi Gjykses gjykon se ky dokument ka vlerë provuese sa u përket pikave të përshkruara më lart, dhe kujton se W04769 mundi të jepte më shumë kontekst në lidhje me këtë dokument.⁶⁴ Gjithashtu, Mbrojtja mundi të bënte pyetje në lidhje me këtë⁶⁵ dhe së paku një ekip i Mbrojtjes është mbështetur në këtë dokument.⁶⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se P652 MFI ka vlerë provuese *prima facie* që nuk zhbëhet nga efekti i tij dëmtues.

37. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e pranon P652 MFI sipas rregullës 138(1).

IV. KLASIFIKIMI

38. Trupi Gjykses vë në dukje se Kërkesa e Veselit, Parashtrimet e ZPS-së dhe Parashtrimet e Mbrojtjes u dorëzuan si konfidenciale dhe nuk janë dorëzuar versione të redaktuara të tyre deri tani. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron palët të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të lartpërmendura, ose të kërkojnë riklasifikimin e tyre deri **të martën, 5 dhjetor 2023**.

⁶⁴ Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 9025-9028.

⁶⁵ Transkripti i datës 17 tetor 2023, f. 9041-9045.

⁶⁶ *Shih* F01052/COR, Mbrojtësi i Specializuar, *Version i Korrigjuar i Dosjes Paraprake në Emër të Kadri Veselit*, 25 tetor 2022, konfidencial, para. 54, me Shtojcat 1-5, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 13 mars 2023, F01052/COR/RED); Transkripti i seancës, 4 prill 2023, f. 2361-2362; Transkripti i seancës, 12 shtator 2023, f. 7862-7870.

V. VENDIM

39. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën e Veselit në lidhje me DKV0801-0802;
- b) **HEDH POSHTË** Kërkesën e Veselit në lidhje me 077601-TR-ET Pjesa 4 RED dhe 077596-TR-ET Pjesa 4 RED;
- c) **MIRATON** Kërkesën e ZPS-së në lidhje me P649 MFI, P651 MFI dhe P652 MFI;
- d) **SHBALL TË TEJKALUAR** Kërkesën e ZPS-së në lidhje me P650 MFI;
- e) **PRANON** si prova sipas rregullës 138(1) materialet në vijim: (i) DKV0801-0802; dhe (ii) faqet e P649 MFI, P651 MFI dhe P652 MFI të përkufizuara në poshtëshënimet 41, 50 dhe 63 të këtij vendimi;
- f) **URDHËRON** Zyrën Administrative që: (i) të caktojë numër prove materiale për DKV0801-0802, përfshirë për përkthimin e tij në anglishte; (ii) ta ndryshojë statusin e provës në 'e pranuar' të faqeve të përkufizuara në poshtëshënimet 41, 47, 50 dhe 63 të këtij vendimi, dhe të caktojë numra të provave materiale për P649, P650, P651 dhe P652, të faqeve përkatëse; dhe
- g) **URDHËRON** palët që të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të Kërkesës së Veselit, Parashtrimeve të ZPS-së dhe të Parashtrimeve të Mbrojtjes, ose të kërkojnë riklasifikimin e tyre deri **të martën, 5 dhjetor 2023**.

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 27 nëntor 2023

Në Hagë, Holandë.